



LOGOS UNIVERSITY COLLEGE  
Quality Assurance Commission



CENTER OF TEACHING AND LEARNING  
<https://ctl.duth.gr/>

## CIKËL I MËSIMESH MBI PEDAGOGJINE UNIVERSITARE



20-27 shtator 2021

LIDHESË: \_\_\_\_\_

GJUHË SEMINARI: Anglisht



## Për Çfarë Bëhet Fjalë

Ndryshimet radikale të paplanifikuara, të sforcuara, të papërgatitura dhe, deri diku, të padëshiruara që pandemia e koronavirusit solli në arsimin e lartë sfidoi çdo model operativ të arsimit të lart (të shoqërisë civile, të tregut pothuaj-shtetëror, të tregut të lire ose të demokracisë sociale), intensifikuan nevojën e trajnimit të stafëve akademike në pedagogjinë universitare, veçanërisht në mënyrat me të cilat instrumente bashkëkohore të teknologjisë mund t'i vihen në ndihmë pedagogjisë. Kjo nevojë është ndjerë tashmë prej kohe në mbare botë, ndërsa disa vende kanë krijuar struktura brenda institucioneve edhe ndërinstitucionale për mësimin, shkëmbimin dhe promovimin e praktikave më të mira.

Për t'i ardhur në ndihmë vetave tona dhe kolegëve të tjerë, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, fal partneritetit të Kolegjit Universitar LOGOS me Universitetin "Demokrit" të Thraçit (UDTh), Greqi, organizon, me mbështetjen e Zyrës së Mbështetjes së Mësimdhënies të atij universiteti, një cikël mësimesh për pedagogjinë univeritare dhe fton pedagogët e Kolegjit Universitar LOGOS dhe kolegë të tjerë, të interesuar, të marrë pjesë. Seminari do të fokusohet në teknikat e të nxënimit me qendër studentin (metoda studentcentrike) në procesin arsimor dhe përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. Cikli I i mësimëve organizohet në katër takime që synojnë promovimin e Pedagogjisë Universitare dhe krijimin e një komuniteti mësimor, për të mbështetur profesorët që të shkëmbejnë praktikën e mira, të shkruajnë nevojat e tyre, të rishqyrtojnë, të zhvillojnë dhe të zbatojnë veprimtaritë arsimore moderne dhe efektive, me përdorimin e TIK-ut edhe në mësimdhënien e lëndëve universitare. Çdo takim do të zgjasë dy orë.

Takimet do të udhëqihen nga anëtarë të Stafit Didaktik Hulumtues, bashkëpunëtorë shkencëtarë të Universitetit Demokrit të Thraçës dhe të Universitetit të Patrës, anëtarë të strukturave të mbështetjes së mësimdhënies dhe mësimnxënies në universitetet në fjalë (të Zyrave për Mbështetjen e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies - ZMMM). Konkretisht:

- Prof. Dr. Zoi Gavriilidou, Zëvendësrektore për Çështjet Akademike, UDTh
- Prof. As. Dr. Katerina Kedraka, Koordinatore e ZMMM-së, UDTh
- Dr. Christos Kaltsidis, kërkues pasdoktoral dhe bashkëpunëtor i ZMMM-së, UDTh
- Prof. Dr. Thanasis Karalis, Koordinator i ZMMM-së të Universitetit të Patrës
- Dr. Natassa Raikou, Stafi Didaktik Laboratorik (SDL) i Universitetit të Patrës



## PROGRAMI

### Takimi I

e enë, 20.09.2021, ora 11.00 - 13.00.

Prof. As. Dr. Katerina Kedraka (Universiteti "Demokrit" i Thraqit)

Lidhesë: \_\_\_\_\_

#### Përmbajtja:

**A.** Hyrje – prezantimi i njëri-tjetrit – bashkëformim i objektivave të Ciklit të të Nxënit

**B.** Diskutimi dhe shkëmbimi i pikëpamjeve të profesorëve të universitetit për:

- Tendencat ndërkombëtare për çështjen e Mësimdhënies Universitare dhe të të nxënit me qendër studentin (studentcentrik).
- Roli didaktik/pedagogjik në lidhje me atë hulumtues; rëndësia e tyre në kontekstin e zhvillimit profesional të anëtarëve të Stafit Didaktik Hulumtues (SDH).
- Pengesat endogjene dhe ekzogjene gjatë mësimdhënies në IAL.
- Efekti i përvojave personale të profesorëve në formësimin e strategjive didaktike.
- Profili dhe nevojat arsimore të studentëve/studenteve.
- Tendencat dhe pikëpamjet bashkëkohore të të nxënit / Rëndësia e teorisë së të nxënit transformues.
- Rëndësia e Komuniteteve Mësimore për anëtarët e SDH-së.

### Takimi II

**E mërkurë, 22.09.21, ora 11.00 - 13.00**

Prof. Dr. Zoi Gavriilidou (Universiteti "Demokrit" i Thraqit)

Lidhesë: \_\_\_\_\_

#### Përmbajtja:

- Hartimi i kurrikulës.
- Përvijimet e mësimëve.
- Çështjet e barazisë dhe të përfshirjes në Arsimin e Lartë.



### **Takimi III**

E premte, 24.09.21, ora 11.00 - 13.00

Prof. Dr. Thanasis Karalis & Dr. Natassa Raikou (Universiteti i Patrës)

Lidhesë: \_\_\_\_\_

Përmbajtja: Qasjet arsimore/ strategji/metoda/ teknika që përdoren në Arsimin e Lartë. Do të diskutohen çështje të tilla (konkretisht):

- Rritja e dukshme e studentëve / studenteve.
- Cilat elemente karakterizojnë mësimnxënien dhe mësimdhënien e “mirë” në Universitet.
- Planifikimi didaktik / Teknikat didaktike.
- Metodatat novatore dhe Praktikat e Mira në mësimdhënie (Flipped Classroom).
- Përforcimi dhe vlerësimi në konventën didaktike dhe të nxënit.

### **Takimi IV**

E henë, 27.09.21, ora 11.00 - 13.00

Dr. Christos Kaltsidis (Universiteti “Demokrit” i Thraçit)

Lidhesë: \_\_\_\_\_

Përmbajtja: Takimi do të përqendrohet në prezantimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe vlerësim në Arsimin e Lartë. Do të diskutohen çështje të tilla, si:

- Mësimdhënia e drejtpërdrejtë dhe në distancë.
- Komunikimi në arsimin internetor (online).
- Strategjitë dhe teknikat e vlerësimit.
- Përdorimi dhe integrimi në mësimdhënie i mjeteve dhe i programeve moderne teknologjike.
- Shembuj dhe Praktika të Mira me përdorimin e TIK-ut.
- Mbyllje - përforcim - propozime për të ardhmen.